

**RAPORTI PERFUNDIMTAR**

**I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**“Bachelor në Teknik i Larte Laboratoresh Mjekësor”**

**Shkolla e lartë private “LOGOS”**

**Eksperti: Prof.dr Ndok Marku**

## Hyrje

### Përbërja e GVJ

#### Parimet e Punës së GVJ

- Besimi
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga GVB, Institucioni etj.
- 

#### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në SHLP “ LOGOS “

- Të dhëna për hapjen e programit të studimit
- HAPJA E PROGRAMIT ESHTË BERE NE PERPUTHJE ME LIGJIN E ARSIMIT TE LARTE Nr. 9741 dt. 21/05/2007, I UDHEZIMEVE Nr. 15 dt. 04/04/2008 dhe Nr. II dt 28/02/20011 dhe urdherit Nr. 26 dt. 17/03/2011

<b>Tabela format</b> për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Bachelor në TEKNIK I LARTE LABORATORESH MJEKESOR , SHLP “ LOGOS “ mbështetur në Standardet shtetërorë për programet e studimit të Ciklit të Parë	
<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit<sup>1</sup></b>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1</b> <b>Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Ofron programe te organizuara ne lende e module dhe te vleresuara ne kredite. Institucioni ofron programe studimi të ciklit të parë, për të cilat është pajisur me licensë nga Këshilli i Ministratve dhe me leje për ushtrimin e aktivitetit akademik nga MASH Programi i studimeve është i organizuar në module, të cilat janë të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Reflektohet ne syllabus te moduleve e lendeve . Totali i krediteve eshte 60 per cdo vit . Programi është hartuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kartën e Bolonjës. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; të ndara në dy semestra. Kreditet për semester janë të shpërndara (Viti I 29-31 ECTS); (Viti II 29-31 ECTS) dhe (Viti III 29-31 ECTS).
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programet , syllabuset jane hartuar ne perputhje me qellimin e misionin e institucionit , që synon një formim sa më cilësor të studentëve bazuar në

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	<b>metodat dhe parimet shkencore.</b>
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Cdo program paraprihet nga nje pershkrim i shkurter se c'fare njohurish dhe aftesish i jep studentit, dhe c'fare njohurish paraprake duhet te kete studenti qe te mund te ndjek e te pervetesoje lenden ose moduln. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Reflektohet ne misionin e Institucionit te Arsimit te Larte " LOGOS " dhe ne pikat e forte te Institucionit.
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	Hartimi i programeve perputhet me zhvillimin ekonomik te vendit. Fusha e Laborantit mjekësor është një prioritet i zhvillimit ekonomik të vendit.
<b>Konkluzione:</b> Te 6 kriteret e mesiperme te standartit I . 1 Ne teresine e tyre plotesohen . Ky konkluzion del nga shqyrtimi i dokumentacionit ne dispozicion dhe verifikimi ne vend i programeve , fleteve te provimit dhe intervistat me studentet .	
<b>Standardi I.2</b> <b>- Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Programet jane hartuar e pershtatur ne perputhje me strategjine e zhvillimit te institucionit. Programi i studimit është përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit, që synon të ofroj një model edukimi dhe specializimi bashkëkohor në përgjigje të kërkesave të kohës, por dhe duke u mbështetur në përvojën 10 vjecare si një Institut 2 vjecar professional.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;	Lendet jane te ndara ne lende te formimit te pergjithshem , te formimit karakterizues dhe te ngjashme me lendet e formimit karakterizues (profesional). Programi i studimit synon pajisjen me njohuritë bazë në fushën e shkencave të përgjithshme si njohuri për anatominë normale, fiziologjinë, terminologjinë mjekësore dhe parimet shkencore të përgjithshme në fushën e biokimisë dhe mikrobiologjisë dhe imunologjisë.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Realizimi I programit bachelor ju jep mundesi te diplomuarve te punojne ne disa disiplina te labororit si biokimi, mikrobiologji, imunologji , etj .
<b>Konkluzione:</b> <b>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1</b> <b>- Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar</p>	<p><b>Dega “ Teknik i Larte Laboratoresh Mjekesor “</b> perputhet me nevojat e tregut te punes . Ky treg pune eshte ne rritje te vazhdueshme sidomos te atij privat.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtare ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Numri i studenteve te rregjistruar e qe vazhdojne vitin e pare eshte me i vogel se ai i viteve II e III . Jane prinderit dhe studentet vete qe orientohen drejt specialiteteve me mundesi me te medhaja punesimi. Kjo shprehet edhe ne intervistat me studentet. Nuk ka studime te mirefillta te institucionit ne kete kendveshtrim .</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Programi i studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës</p>	
<p><b>Standardi II.2</b> - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	<p>Programi i studimeve në Laborant Mjekësor nuk bie ndesh me interesat kombëtare; ai synon të përgatisë profesionistë që do të punojnë në fushën e laboratoreve mjekësore.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimeve synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Ai synon gjithashtu në përgatitjen e specialistëve që do të punojnë në fushën e laboratoreve mjekësore.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Programi i studimeve në Laborant Mjekësor synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe të interesave kombëtare.</p>	
<p><b>Standardi II.3</b> - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Senati i Institucionit perdor metodologji vleresimi per ecurine e programeve te studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p>	<p>Senati harton raport vleresues vjetor dhe ja bene te ditur strukturave shteterore perkatese.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>IAL ka publikuar në faqen e internetit informacione dhe të dhëna që kanë të bëjnë me rezultatet që synon të arrijë Institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës,</li> </ol>	<p>Perdor metoda te vleresimit si sondazhe me studentet qe ndjekin programet . Sondazhet kane te bejne me permbajtjen e lendeve , moduleve , menyren e dhenjes se leksioneve , aftesite komunikuese te pedagoqeve, mundesite qe Institucioni ka per realizimin e praktikave profesionale.</p>

<p>të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p><b>Te diplomuarve te pare bachelor ju mbetet te marrin pjese ne provimin e shtetit per profesionet e rregulluara . Mbetet qe institucioni te disponoj te dhena ne te ardhmen per rezultatet e studenteve te diplomuar nga SHLP “ LOGOS “ .</b></p> <p><b>Vleresimi i studenteve behet ne vazhdim . 45 % vlereson me seminare e praktika profesionale . 55 % ne provim perfundimtare . Provimet jane lend – provim ose lend te integruara- provim vleresimi eshte me note .</b></p> <p><b>Vleresimi eshte ne perputhje me vleresimet ne Institucionet publike si motra ne RSH .</b></p>
<p><b>Konkluzione:</b>  <b>Për akreditimin e programit të studimit, institucioni përdor instrumente të drejtpërdrejta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b></p>	
<p><b>Standardi II.4</b>  <b>- Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Njësitë kryesore përgjegjëse për këtë program studimit është Departamenti përkatës, i cili gjatë gjithë kohës jep informacione të nevojshme për përmbajtjen e programit të studimit. Gjithashtu edhe në sekretarinë mësimore studentët mund të informohen mbi këtë programe. Faqja e internetit jep të dhëna të mjaftueshme për programin e studimit Laborant Mjekësor.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	<p>Eshte e reflektuar ne programet qe Institucioni shpall dhe ju ofron studenteve</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	<p>Eshte e reflektuar ne programin e shpallur. Studentet duhet te frekuentojne 75 % te leksioneve, seminareve e laboratoreve qe te fitojne te drejten e vleresimit me note (provim). Mbahen rregjistra te rregullt te frekuentimit .</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Në planin mësimor dhe në programet e lëndëve dhe në evidencat e secilit pedagog jepen të dhënat e nevojshme për ngarkesën mësimore, për orët në auditor, për frekuentimin ndjekjen e programit. Ka syllabuse per lendet formuese te pergjithshme, karakterizuese dhe lendet me zgjedhje . Studentët i marrin informacionet e nevojshme nga sekretaria mësimore dhe nga pedagogët e lëndëve përkatëse në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin apo ndjekjen e programit.</p>

<b>Konkluzione:</b> Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<b>Standardi II.5</b> - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Eshte e reflektuar në raportin e vetvlerësimit me shifra situata financiare e Institucionit. Sipas këtij raporti edhe sipas dokumentacionit të parë në vend, shpenzimet për vitin 2010-2011, i vlefshëm edhe për 2011-2012 janë si më poshtë: - Të ardhurat në studentët - Kontributi i themeluesit
<b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj.;	Jepen zerat baze te shpenzimeve te shprehura ne shifra, si për : - Materiale të konsumuara - Pagat - Sigurimet - Tatimet - Etj.
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Jepet kontributi i themeluesit te SHLP “ LOGOS “, shkelqesia e tij Prof. Dr .Anastasi. Institucioni eshte “ non profit” . Në raportin e vetvlerësimit bëhet një pasqyra e qartë e granteve të dhënë nga themeluesi i Institucionit.
<b>Konkluzione: Ploteson kriteret e standartit II . 5</b>	
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1</b> - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Ndjek procedura ligjore te rekrutimit te personelit . Personeli i punesuar me kontrate te pjesshme ose te plote ka dokumentacionin sipas ligjeve ne fuqi me RSH. Dokumentacioni për personelin akademik të punësore me kohë të plotë ose të pjesshme u pa në vend dhe dosjet e tyre ndodheshin në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Pjesa me e madhe e personelit te punesuar mesimdheneese eshte part – time. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën më pak se 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit të ciklit të parë.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Sipas raportit të vetvlerësimit dhe konstatimit gjatë bisedave si me personelin akademik ashtu edhe me anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm, Institucioni i kushton një kujdes të veçantë, përveç dosjeve personale të paraqitur, formimit edukativo-kulturor dhe etiko-moral të tij. Aplikimet vlerësohen paraprakisht nga ana e rektoratit me të cilin lidhin kontrata e punës, i cili merr në intervistë kandidatin.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	Institucioni i ruan të dhënat për përzgjedhjen e personelit akademik, madje ne sekretari ashtu siç është përmendur edhe më lart, mund të gjenden

	këto dosje.
<b>Konkluzione:</b> Mbetet qe Institucioni te shtoj punesimin e personelit akademik me kohe te plote qe gradualisht te plotesoj kriterin 2 te standartit III . 1 . Cilesia e personelit akademik part – time eshte e kenaqeshme me tituj akademik e pervoje mesimdhenje te gjate ne Institucionet publike te arsimit te larte .	
<b>Standardi III.2</b> <b>- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Materialet që Institucioni disponon dhe u panë gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, ku dhe mbareshin këto dosje, ishin per cdo personel akademik: diplome, liste notash (te noterizuara), tituj akademik (te noterizuara ), CV, specializime .
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;	Në raportin e vlerësimit të brendshëm, institucioni ka paraqitur një listë e gjithë personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për të gjithë Institucionin. Të dhëna më të veçanta për programin e studimit gjenden në syllabuset përkatëse, ku dhe është paraqitur pedagogu i lëndës.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;	Institucioni aplikon procedura të vecanta të rekrutimit të personelit akademik. Rekrutimi bëhet me anë të dosjeve. Nga rektorati bëhet vlerësimi I dosjeve dhe më pas realizohet intervista. Këto të dhëna gjenden edhe në RVB.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.	Pjesa me e madhe e personelit mesimdhene eshte me tituj akademik e shkencor si: Doktor , Prof. i Asociuar, Profesor.
<b>Konkluzione:</b> Ploteson kriteret e standartit III . 2	
<b>Standardi III.3</b> <b>- Institucioni angazhon personel ndihmës mësimorshkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Ka personel te mesem (citim teknik profesional) specialist per organizimin e praktikave laboratorike e mirembajtjen e aparaturave e mjediseve laboratorike.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;	Numri I vogël I studentëve e bën më të lehtë angazhimin e personelit ndihmës mësimore, gjë që u verifikua gjatë kontaktit dhe bisedave me studentët si dhe gjatë vëzhgimit të mjediseve laboratorike.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	Institucioni ka aganzhuar mjaftueshëm personel për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale pasi ky institucion ka një eksperiencë të mëparshme me Institutin 2 vjeçar.
<b>Konkluzione:</b> <b>Bazuar në komentet e mësipërme, mendoj se ka një përputhje të standartit dhe kriterëve të tij, pasi personeli ndihmës në mjediset e laboreve është i mjaftueshëm, konsideruar edhe numrin e pakët të</b>	

<b>studentëve.</b>	
<b>Standardi III.4</b> <b>- Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;	Institucioni ka marrëveshje bashkepunimi të hapur dhe partneritet me Universitetin e Pireut, Greqi.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.	Institucioni disponon të dhëna bazë për personel akademik të angazhuar dhe të programeve që ai ofron.
<b>Konkluzione:</b> Nisur nga komentet e mësipërme, konkludoj se standardi dhe kriteret janë plotësuar.	
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1</b> <b>- Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Institucioni i Arsimit të Lartë ka kriteret e veta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve por gjithashtu përzgjedhja e studentëve në këtë cikël është në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Institucioni i Arsimit të Lartë ka kriteret e veta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Kerkohet nje motivim i studenteve qe zgjedhin te ndjekin SHLP " LOGOS "
<b>Konkluzione:</b> Institucioni i Arsimit të Lartë ka kriteret e veta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	
<b>Standardi IV.2</b> <b>- Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;	Nga biseda me grupin e vlerësimit të brendshëm, rezultoi që studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.
<b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;	Vleresimi i pedagogëve bëhet në bashkëbisedim me drejtuesit e këtij Institucioni . Ata janë të perfaqësuar dhe të lire në dëgjimin e vlerësimeve për pedagogët .
<b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;	Nuk ka një qendër që të ofrojë shërbimin e këshillimit të karrierës. Kjo bëhet në mënyrë spontane nga pedagogët
<b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	Ne përgjithësi informohen. SHLP dega laborator është e lidhur me poliambulancën " Ungjellizimi".
<b>Konkluzione:</b> Institucioni bën përpjekje për të informuar studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<b>Standardi IV.3</b> <b>- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;	Institucioni ka statistika vjetore për numrin e studentëve në ciklin e parë.



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u vërejt se institucioni kishte statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, gjithashtu në regjistrat e kontrulluara gjendeshin të dhëna për studentët e larguar ose të tërhequr.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u vërejt se institucioni mbante një informacion të qartë për ecurinë e studentëve gjatë gjithë programit të studimit. Në sekretari gjenden të dhëna që nga regjistrimi i studentit, notat gjatë viteve të studimit, dosjet personale të tyre dhe procesverbalet e provimeve.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p><b>Standardi IV.4</b> - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p>	<p>Nuk kemi konstatuar që te këto një zyre këshillimi karriere. Ajo behet kryesisht nga anetaret e senatit të SHLP "LOGOS".</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Praktikat profesionale behen brenda Institucionit dhe në spitalin (poliambulancën) "Ungjellizimi".</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Megjithatë nuk ka një qendër të këshillimit të karrierës, Institucioni ndjek progresin e studentëve dhe i ndihmon në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p>	
<p><b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b></p>	
<p><b>Standardi V. 1</b> - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p>	<p>Ka biblioteke me hapsire të mjaftueshme. Gjatë vizitës nëpër ambjentet e bibliotekës u vërejt se ishin në total 3 dhoma të vecantë që përdoren për bibliotekë.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p>	<p>Literatura nuk është e sistemuar por është në proces të sistimit të saj në bashkpunim me Universitetin Pireus. Greqi</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p>	<p>Gjatë vëzhgimit të ambjenteve u vërejt se institucioni ka sisteme kompjuterike të lidhura me Internet, gjithsej ishin 3 salla kompjuterash.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p>	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm del qartë se institucioni ka parashikuar një zë i cili do të mbulojë: mobilimin e vazhdueshëm me vlera të konsiderueshme në asete dhe pajisje të nevojshme për procesin mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë kohës së mesimdhënjes.</p>

<p><b>Konkluzione:</b>  <b>Institucioni ka një bibliotekë e cila sapo është furnizuar me një fond të ri nga Universiteti i Pireut. Biblioteka shërben me salla leximi dhe me skedar elektronik për gjetjen e materialeve. Ajo pasurohet vazhdimisht dhe u shërben studentëve deri në orën 19:00. Nuk ka bibliotekë on-line. Por mbetet për tu sistemuar pasi ambientet dhe pajisjet elektronike ekzistojnë mjaftueshëm.</b></p>	
<p><b>Standardi V. 2</b>  <b>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Ka laborator të mjaftueshëm për praktikën profesionale dhe klasa për mesimdhënie komode dhe me mjete video – retroprojektor. Institucioni ka 2 laboratorë mjekësorë dhe 3 salla kompjuterash. Të gjitha të dhënat e përmendura dhe që përmbushin këtë kriter u verifikuan në vend.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mesimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e laboratorëve, sallave të leksionit dhe sallave të seminarëve, u vërejt se ato ishin të pajisura me të gjithë mjetet e nevojshme për të zhvilluar orët mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p>	<p>gjatë vëzhgimit të ambienteve, u pa se institucioni është i pajisur me aparatura të mjaftueshme për materializimin e njohurive teorike .</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p>	<p>Ka dy laboratore: Klinik – Biokimik (I cili përmban pajisjet si: centrifugen, fotometër, pipeta automatike etj) dhe Mikrobiologjik (I cili përmban pajisje si: thermostat, sisteme fiksimi dhe ngjyrimi për ekzaminimet bakterologjike etj).</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p>	<p>Ka pajisje elektronike, kompjuterike që mbulon programet për teknik të lartë laboratorësh mjekësorë .</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Studentëve institucion i garanton, me kapacitetet që zotëron si dhe me laboratorët e Poliambulancës “Ungjillizi” mjedisin e mjaftueshëm për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
<p><b>Konkluzione:</b>  <b>Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b></p>	
<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>- Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p>	<p>E ka të pasqyruar në raportin për vlerësimin e akreditimit të institucionit .</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p>	<p>Jane kuotat e shkollimit për vitin akademik 2010 – 2011 të vlefshme dhe për vitin 2011 – 2012</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri</p>	<p><b>VLERËSIM INSTITUCIONAL</b></p>

financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	
<b>Konkluzione:</b> Bazuar në parimin e besimit dhe në raportin e vlerësimit të brendshëm mendojmë që ky <u>standard plotësohet</u> .	
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1</b> - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Logos ka nxitur bashkëpunimin eficient dhe efektiv ndërmjet personelit të tij, duke u kujdesur vazhdimisht në mbarëvajtjen e marrëdhënieve të mira e bashkëpunuese ndërmjet tyre. Nga takimet me pedagogët dhe grupin e vlerësimit të brendshëm u konstatua se institucioni nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Nga biseda me pedagogët dhe grupin e vlerësimit të brendshëm u vë re se ka ndarje të detyrave midis personelit dhe jo mbivendosje të tyre, gjë që bën secili, të masë përgjegjësitë përkatëse për mbarëvajtjen e mësimdhënies. U krijua bindja e marrëdhënieve të frytshme bashkëpunimi midis personelit brenda institucionit.
<b>Konkluzione:</b> Nga biseda me pedagogët dhe grupin e vlerësimit të brendshëm reagimi ishte shumë pozitiv. Si konkluzion, mund të themi që institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të angazhuar. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
<b>Standardi VII.2</b> - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Ka marrëdhënie bashkëpunimi me Universitetin Pireu – Greqi dhe funksionon në kuadrin e fondacionit “LOGOS”.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;	Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi ngaqë funksionon në kuadër të Fondacionit Logos në të cilin përfshihet klinikat e ambulancës “Ungjillizimi”.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Institucion parashikon trajnime profesionale për personelin akademik të brendshëm. Gjithashtu gjatë bisedës në institucion u konstatua se personi përgjegjës për bibliotekën, aktualisht ndodhej në Greqi për një kurs trajnimi bibliotekar.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk reflektohet.
<b>Konkluzione:</b> Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me ambulancën e “Ungjillizimi”.	
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	

<b>Standardi VIII.1</b> <b>- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	<b>Institucioni është në procesin e vlerësimit institucional.</b>
<b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	<b>Institucioni përdor instrumenta për sigurimin e cilësisë por jo si një njësi e pavarur e sigurimit të cilësisë.</b>
<b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;	<b>Mbetet për tu ndjekur në vazhdimin pas akreditimit të programeve nga AAPAL .</b>
<b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;	<b>Realizohet nga senati i Institucionit.</b>
<b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	<b>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</b>
<b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	<b>Ka një strategji në kuadrin e Senatin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë megjithëse procedurat nuk janë të qarta dhe jo të publikuara.</b>
<b>Konkluzione:</b> <b>Institucioni përpiqet për të siguruar cilësi në realizimin e programeve të studimeve.</b>	

### **Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit**

#### **Pikat e forta**

1. Janë të reflektuara në raportin për vlerësimin e akreditimit të Institucionit, pikat të cilat i vlerësoj si të mirëqena.

#### **Pikat e dobët**

1. Mungesa e stafit akademik të brendshëm sipas kërkesave të ligjit të Arsimit të lartë.
2. Mungesa e kordinatorëve për grup lëndesh të integruara.
3. Sistemi i bibliotekës sipas programeve që SHLP "LOGOS" ofron
4. Nuk ka një zyrë këshillimi korriere të studentëve me dokumentacionin përkatës.
5. Nuk përfaqësohen studentët në senat me një anëtar të përhershëm.

#### **Kërcënimet**

1. Rënia e numrit të studentëve të regjistruar në vitin e parë mund të jetë një kërcënim për vazhdimësinë e këtij Institucioni të arsimit të lartë

#### **Oportunitetet**

1. Funkcioni në kuadrin të fondacionit "LOGOS" është një oportunitet për të vlerësuar dhe të qenurit si një Institucion "non profit".

### **Rekomandimet**

1. Venja sa me shpejte ne funksion te biblotekes per studentet
2. Te rritet numri i studenteve me tema per mbrojtjen e diplomes
3. Te punohet me shume per kontrata bashkepunimi me Institucione publike te Arsimit te Larte si QSU “ Nene Tereza “ dhe spitali jo publik “ Hygea “, i cili ka volum pune e teknologji bashkekohore ekzaminimesh laboratorike .
4. Rregjistri themelor te mbyllet me vije te kuqe dhe numer rendor .
5. Rritja e personelit akademik te brendshem sipas kerkesave te ligjit te Arsimit te larte.

### **Grupi i Ekspertëve të Jashtëm**

1. Prof. Dr. Ndok MARKU